

Znj. Marjana Lami

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, protokolluar me nr. 10818 prot., datë 27.12.2023, ju informojmës se:

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ka si mision mbulimin e të gjithë popullsisë me element të sigurimeve shoqërore dhe akordimin e përfitimeve për personat që plotësojnë kushtet për përfitim sipas Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Referuar sistemit të pagesave të pensioneve PCAMS, rezulton se, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, bazuar në nenet 32/40/41, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me vendim caktim pensioni nr. 40472/1, datë 21.08.2023, i ka caktuar vajzës tuaj, znj. Loreta Lami, pension familjar nga i ndjeri z. Ilir Islam Lami, me periudhë sigurimi 7 vite e 2 muaj dhe me masë pensioni 3. 904 lekë në muaj.

Sa më sipër, vajza juaj është përfituese nga skema e sigurimeve shoqërore dhe kërkesën tuaj në lidhje me tarifat e tjera lehtësuese që ajo mund të përfitojë gjatë kohës që vazhdon studimet, duhet t’ia adresoni institucionit arsimor në të cilin ndjek studimet.

Faleminderit për mirëkuptimin.